



Npi – 01/32 datë: 28.01.2022

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 28.01.2022 është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I M B L E D H J E S Ë -I- T Ë R R E G U L L T T Ë K U V E N D I T T Ë K O M U N Ë S S Ë S H T I M E S
E mbajtur më: 28.01.2021, (e premte) në ora 10.⁰⁰ h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adbab Ademi, Antarët e Kuvendit: Rrahman Jakupi, Perparim Ramusa, Lumni Amrushi, Besartë Musliu-Spahija, Adem Ramadani, Hasan Avdyli, Hamëz Tërshani, Albana Podvorica, Adelina Beqaj, Besnik Seferi, Gëzim Haxhiu, Reshat Mujota, Asllan Beqaj, Shkurte Mustafa, Sanije Sadiku, Heroina Selmani, Kadri Emini, Rrezartë Ramadani, Muhamet Ademaj, Rexhep Gashi.

Në mbledhje përveç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Drejtorët, nga ZKF-ja z.Bujar Ferati dhe znj.Kimete Ukaj; Nga Zyra Ligjore, z.Lulzim Muharremi, nga OJQ “YAHR” z.Egzon Ahmeti, Nga Zyra për Informim, z.Gazmend Ademaj, nga Radio Zëri i Shtimes, z.Muhamet Hoxha, dhe dia qytetarë të interesuar.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstattoj, Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit.

Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 08.12.2021,
2. Raport vjetor i buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor 2021,
3. Draft-Rregullore komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2022,
4. Zgjedhja e Komisionit për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për 2022,
5. Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të rregullta të KK për 2022,
6. Zgjedhja e Komitetit për Politikë dhe Financa,
7. Zgjedhja e Komitetit për Komunitete,
8. Zgjedhja e Komitetit për Arsim, Kulturë Rini dhe Sport,
9. Zgjedhja e Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale, Ambient e Shërbime Publike,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se të hapi diskutimin për rendin e ditës, propozoj që ta fusim si pikë shtesë të rendit të ditës edhe “Propozim-Vendimin për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi”, me qëllim që mos të humbim edhe një muaj kohë pa nevojë për themelimin e tijë. Në vazhdim e hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Reshat Mujota; Nuk është hapur mirë rendi i ditës, sepse fillimisht lexohen pikat e rendit të ditës e pastaj hapet diskutimi.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, pajtohem që nuk është hapur mirë rendi i ditës, mirëpo unë propozoj që pikat 6, 7, 8, dhe 9 të dalin të parat për shqyrtim, kuptohet pas shqyrtimit të ekstrakt procesverbalit.

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, unë propozoj që në rendin e ditës të futet edhe pika Pyetje-përgjigje.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, edhe unë pajtohem që në rendin e ditës të futet edhe pika Pyetje-përgjigje.

z.Idajet Rexhepi, Zyrtar i Kuvendit; Unë dua të sqaroj se pika për formimin e KKSB-së është shumë e rëndësishme që të aprovohet në këtë mbledhje, se sa pika Pyetje-përgjigje. Unë mendoj se kjo pikë në këtë mbledhje nuk është futë vetëm për arsye se është mbledhja e parë, dhe është e ngarkuar shumë, me pika tjera për themelimin e Komiteteve, kjo pikë mund të mbetet për mbledhjet e ardhëshme të Kuvendit, sepse edhe neni 6.3 i rregullores së punës së Kuvendit thotë "Anëtar i Kuvendit mund të propozoj shtimin e një pike të rendit të ditës vetëm nëse ajo është urgjente dhe me rëndësi publike".

znj.Adelina Beqaj; Zotëri, Rexhepi me gjithë respektin por këtë sqarim duhet me na e dhënë Kryesuesi i Kuvendit e jo ti.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 10 vota "Për" me 11 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" nuk e aprovoi, propozimin e Kryesuesit të Kuvendit që të futet si pikë shtesë edhe pika "Propozim-Vendimin për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi".**

*** Kuvendi i Komunës, me 12 vota "Për" me 5 vota "Kundër" dhe me 4 vota "Abstenim" aprovoi, propozimin e Perparim Ramusa, që pikat 6, 7, 8, dhe 9 të dalin të parat për shqyrtim, pas ekstrakt procesverbalit.**

z.Rexhep Gashi; Ne e kemi miratuar vetë rregulloren e punës së Kuvendit, edhe duhet ta respektojmë.

znj.Adelina Beqaj; Propozoj që pika Pyetje-Përgjigje të mbetet pas pikave për zgjedhjen e Komiteteve.

*** Kuvendi i Komunës, me 14 vota "Për" me 7 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" aprovoi, propozimin e Adelina Beqaj që pika Pyetje-Përgjigje të mbetet pas pikave për zgjedhjen e Komiteteve.**

Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi rendin e ditës si vijon:

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 08.12.2021,
2. Zgjedhja e Komitetit për Politikë dhe Financa,
3. Zgjedhja e Komitetit për Komunitete,
4. Zgjedhja e Komitetit për Arsim, Kulturë Rini dhe Sport,
5. Zgjedhja e Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale, Ambient e Shërbime Publike,
6. Pyetje-Përgjigje,
7. Raport vjetor i buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor 2021,
8. Draft-Rregullore komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2022,
9. Zgjedhja e Komisionit për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për 2022,
10. Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të rregullta të KK për 2022,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Në vazhdim Kryesuesi fjalën ja dha Kryetarit.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Përshëndetje për të gjithë, meqenëse është mbledhja e parë e rregullt e Kuvendit i uroj punë të mbarë, por para se të vazhdojmë me punën, propozoj një pauzë prej 10 minutave.

z.Rrahman Jakupi; Unë jam për me vazhdu mbledhjen e Kuvendit për themelimin e trupave punuese të Kuvendit. Komunitet tjera i kanë themeluar organet e Kuvendit kështu që edhe ne nuk duhet të vonohemi.

z.Rexhep Gashi; Edhe unë jam për një pauzë prej 10 minutave.

z.Hamëz Tërshani; Unë nuk jam për pauzë.

z.Përparim Ramusa; Duhet ta qesim në votim e jo të shkojmë ashtu në pauzë.

z.Besnik Seferi; Unë jam për me pas një pauzë, por është mirë që përfaqësuesit e grupeve parlamentare të merren vesh, sidoqoftë unë jam që të votohet edhe mbajtja e pauzës.

z.Reshat Mujota; Pauza duhet të votohet, por unë jam që ta mbajmë një pauzë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Dha 10 minuta pauzë.

Mbledhja e Kuvendit vazhdoi në ora 11.20h.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 08.12.2021

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Rrahman Jakupi; Te propozimi për formimin e Komisionit Verifikues, në vend të emrit Rrahman Jakupi duhet të jetë Përparim Ramusa.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më: 08.12.2021 me ndryshimin e propozuar.**

Pika 2

Zgjedhja e Komitetit për Politikë dhe Financa

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Kadri Emini; Përshëndetje, po besoj se është mirë që me qenë edhe Kryetari prezent.

z.Reshat Mujota; Sa i përket prezencës së Kryetarit, nuk është e obligueshme, ne e kemi Kryesuesin e Kuvendit dhe mund të vazhdojmë, nuk ka mundësi që ne tash ta presim Kryetarin.

z.Hamëz Tërshani; Unë pajtohem me Reshatin, sepse pushtetet janë të ndara, dhe nuk kemi nevojë me pritë Kryetarin.

z.Rrahman Jakupi; Është një Udhëzim Administrativ i MPL-që e kemi marrë, mbi bazën e të cilit unë po kërkoj që të procedojmë sipas nenit 6 pika 5 tutje, (në vazhdim ky e lexoi këtë nen) kështu që unë po kërkoj që të procedojmë sa më parë.

z.Kadri Emini; Sa i përket Komitetit për Politikë dhe Financa, unë mendoj se ndarja duhet të bëhet në këtë formë. Subjekt politik PDK, duhet ti ketë tre anëtarë, njëra femër. LVV, duhet të ketë dy anëtarë, dhe LDK-AKR, duhet të ketë dy anëtarë. Në këtë rast ka mundësi që të ndahet në bazë të grupeve parlamentare.

z.Hamëz Tërshani; E spjegoi kolegu Kadri Emini, por unë mendoj se është mirë që ta spjegoi edhe Kryesuesi i Kuvendit.

z.Kadri Emini; Unë mendoj se nuk është e rëndësishme se kush, por e rëndësishme është që u sqarua procedura Ligjore.

z.Reshat Mujota; Kadriu duhet me folë vetëm për grupin e vet parlamentar, e jo edhe për grupet tjera parlamentare.

z.Përparim Ramusa; Unë po propozoj që anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa nga Grupi parlamentar i PDK-së të jetë, Perparim Ramusa, Lumni Amrushit dhe Adelina Beqaj.

z.Rexhep Gashi; U elaboru qelësi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa. Unë e falënderoj Kryesuesin që na ka thirrë përfaqësuesit e grupeve parlamentare për konsultime, unë kam

marrë pjesë në takim dhe aty jemi dakorduar që qelësi është përbërja prej 7 anëtarëve ku PDK do të ketë 3 anëtarë, LVV - 2 anëtarë, LDK - 1 anëtarë dhe LB - 1 anëtarë, në takimin që kemi pas, kështu jemi marrë vesh.

z.Besnik Seferi; Kam një kritikë për Sekretarinë, sepse është dashur me na i dërguar edhe Rregulloren e punës së Kuvendit.

z.Idajet Rexhepi, Zyrtar i Kuvendit; Këtë kritik nuk mund ta pranoj, sepse e vërteta është se unë ua kam dërguar jo vetëm rregulloren e punës por edhe Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale edhe Udhëzimet Administrative edhe Doracakun e MPL-së në formë broshure e kemi shpërnda në mbledhjen inauguruese, por ato duhet të lexohen, para se të bëhet kritika.

z.Besnik Seferi; Unë mendoj se Kryesuesi i Kuvendit shkon me automatizëm si Kryesuesi i KPF-së. Propozoj që në Komitetin për Politikë dhe Financa të shkojë me automatizëm Adnan Ademi, si dhe Sanije Sadiku e Rexhep Gashi.

z.Reshat Mujota; Këtu nuk ka marrveshje, këtu jepen propozimet dhe kush i merr votat hynë në Komitetin për Politikë dhe Financa.

z.Muhamet Ademaj; Në emër të LDK-AKR-së unë e propozoj Kadri Eminin.

z.Kadri Emini; Unë po tërhiqem nga kandidatura për arsye të kuotës gjinore, dhe propozoj Besartë Ramadanin për anëtare të Komitetit për Politikë dhe Financa.

z.Reshat Mujota; Unë e propozoj Heroina Selmanin.

z.Besnik Seferi; Unë kërkoj interpretim ligjor për këtë çështje.

z.Lulzim Muharremi, zyrtar ligjor; Përshëndetje, në vazhdim, lexoi disa pjesë nga Doracakun "Udhëzues për Inagurimin dhe Funksionalizimin e Organeve të Komunës" (shih stenogramin).

z.Përparim Ramusa; Është e vërtetë që e kemi mbajtur paraprakisht një takim konsultativ për ta gjetë qelësin për përfaqësimin e subjekteve në KPF-ë. Unë propozoj që çdo emër që propozohet të del në votim.

z.Besnik Seferi; Tani kemi 8 propozime, unë po kërkoj që të deklarohet Reshat Mujota, se a është në grupin parlamentar të Lëvizjes Vetvendosje apo jo?

z.Reshat Mujota; Me vetë faktin që nuk jam ulur te grupi parlamentar i Vetvendosjes tregon se unë jam diçka i pa kënaqur, sepse mendoj se duhet të kemi një meritokraci. Është e vërtetë se unë kam qenë për ndryshim në Komunën e Shtimes, sepse te PDK-ë u tepru zunën me u rritë pak edhe në mendje, dhe me kriju familjarizëm dhe jam largu nga aty. Jam ardhur në listën e LVV-së, mirëpo edhe këtu nuk u mbajtën marrveshjet e meritokracisë. Këtë sçarim po e jap për qytetarët e Komunës së Shtimës, se ju këto i dini mirë, por duhet të jenë në dijeni edhe qytetarët pse unë ndodhem, sot në këtë ulëse. Për sa i përket pauzës ne kemi pas mjaftë kohë për me u përgatitë. Po e them ashtu siç ka thënë edhe Albini se duhet të vijë në shprehje meritokracia, e jo bashkëpunim me komunën e Kaqanikut, mos të keqkuptojë drejtori nga Kaqaniku se nuk kam asgjë personale me te, por mendoj se ka kuadra mjaftueshëm edhe në komunën tonë. Tani unë sot në Kuvend jam si anëtarë i pavarur.

z.Kadri Emini; Shkoj, gjatë kjo punë, por një gjë dua të them se kjo nuk shkon mbi bazën e votave, por që subjektet duhet të merren vesh për qelësin sepse struktura politike e Kuvendit duhet të reflektojë edhe në KPF. Meqenëse LVV-ja e humbi një kandidat, atëherë unë mendoj se duhet të shkojmë sipas qelësit PDK 3, LVV 2 anëtarë, LDK-AKR, 1 anëtarë dhe Reshati ose Heroina me 1 anëtarë.

z.Rrahman Jakupi; Anëtarët e Kuvendit mund të bashkohen në ndonjë grup, por nuk kemi grup të formuar zyrtarë. U.A. thot propozimet nga subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend.

z.Besnik Seferi; Ne më parë gjithëherë e kemi përmendur si grup parlamentar, e sot këtu nuk po themi se ka grup parlamentar. Propozoj që të votohet për secilin propozim.

z.Përparim Ramusa; Duhet votuar kandidatët e propozuar me emër secili veç e veç.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Mendoj se është më mirë që të na sqarojë edhe një herë zyrtari ligjor se si shkon kjo procedurë

z.Lulzim Muharremi, zyrtar ligjor; Ligji e njeh si entitet ose subjekt politik.

znj.Adalina Beqaj; Asnjëher nuk është shkelur rregullorja e punës më shumë se sot.

z.Reshat Mujota; Është e vërtetë që rregullorja e jep për të njëjtën pikë dy herë. Propozimi qitet në votim dhe kaq ka këtu.

z.Muhamet Ademaj; Kërkoj që ti japim zgjidhje këtijë problemi, dhe të jemi më konstruktiv. Te propozimet e PDK-së është në rregull, te LVV-ja Adnani dhe Sanija, dhe te LDK-AKR-ja Kadri Emini, dhe anëtarë i shtatë Heroina Selmani që e propozoi Reshati e që po plotësohet numri prej shtatë anëtarëve..

z.Lulzim Muharremi, zyrtar ligjor; Sqaroi se KPF-në e përfaqësojnë entitetet politike që janë pjesë e Kuvendit.

z.Kadri Emini; KPF-ja duhet të shkoj në variantin që e thash më herët. Mirëpo unë po propozoj që kjo mbledhje të shtyhet për javën e ardhëshme.

z.Përparim Ramusa; Propozimi i Kadriut për shtyrjen e mbledhjes është i pa arsyeshëm. Unë jam që të vazhdojmë me mbledhjen dhe propozoj që çdo propozim të votohet dhe të shkojmë tutje, sepse MPL-ja vendos për ligjshmërinë e tyre.

z.Besnik Seferi; Kërkoj falje për këtë rrëmuje që është krijuar, por kjo ka ndodhur edhe më parë. Po tërhiqemi nga propozimet tona si LVV-ë, dhe po propozojmë Adnan Ademin me automatizëm dhe Sanije Sadikun.

z.Rexhep Gashi; Unë po besoj se anëtarët e Kuvendit tashmë e kanë të qartë si duhet vepruar sipas ligjit. Nuk bëhet nami mos me më propozuar mua askush, sepse sipas ligjit e kam të drejtën që vetë me e propozuar vetveten. Unë po sygjeroj që në KPF-ë me shkuar emrat që kanë më shumë përvojë, ku edhe i njohin çështjet më mirë. Kështu pra unë e propozoj vetveten Rexhep Gashi për anëtarë të KPF-së, sepse ma jep këtë të drejtë ligji. Ndoshta e marr veq votën time nuk e di, qite në votim ta shohim. LVV-ja bëri disa herë propozime herë njërin e herë tjetrin

z.Besnik Seferi; Neve na takojnë dy anëtarë, nuk ka të pa qartë asgjë, jemi përfaqësues të popullit.

z.Rexhep Gashi; Replikë me Besnik Seferin, nuk e di pse po më paragjykon mua se a kam të drejtë apo jo me propozuar. Askush nuk ka të drejtë me thënë se Lëvizja për Bashkim (LB) nuk ka të drejtë me propozuar.

z.Besnik Seferi; Unë po dua që ta lexojë zyrtari ligjor U.A. për sa i përket se a i takon LB-së që të ketë propozim.

z.Lulzim Muharremi, zyrtar ligjor; Kryesuesi i Kuvendit, shkon me automatizëm, dhe nuk përfshihet në numrin e anëtarëve që propozohet nga subjekti politik, por qelësi për përfshirjen e numrit të anëtarëve nga subjektet politike duhet të gjendet në marrveshje mes tyre.

z.Rrahman Jakupi; Kisha pas dëshirë që me pa se ku po shkruan që Kryesuesi shkon me automatizëm. Propozoj që propozimet e dhëna të votohen një për një.

z.Lulzim Muharremi, zyrtar ligjor; Neni 5 pika 2 i U.A. i MPL-së ku thot "Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteteve politike në Kuvendin e Komunës" edhe, Neni 52.1 i LVL-së thotë "Komiteti për politikë dhe financa kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteve politike në Kuvendin e Komunës".

z.Rrahman Jakupi; Unë thash se askund nuk shkruan se Kryesuesi është apolitik.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Propozoj që kjo mbledhje të shtyhet për një ditë tjetër.

z.Përparim Ramusa; Në emër të PDK-së ne nuk jemi të mendimit se mbledhja duhet të shtyhet.

z.Besnik Seferi; Edhe unë pajtohem me propozimin që mbledhja të shtyhet.

z.Reshat Mujota; Unë propozoj që mbledhja e Kuvendit të vazhdohet. Unë jam për me e zgjedhë Komitetin për Politikë dhe Financa, kërkoj që të qiten në votim secilin kandidat, kush kalon mirë kush jo skemi qka i bëjmë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

* Kuvendi i Komunës, me 10 vota "Për" me 11 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" nuk e aprovoi, propozimin e Kryesuesit të Kuvendit për me shty mbledhjen e Kuvendit për një ditë tjetër.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Tani duhet të shkojmë me propozimet një nga një.

z.Përparim Ramusa; Unë po propozoj që anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa nga Grupi parlamentar i PDK-së të jetë, Perparim Ramusa, Lumni Amrushit dhe Adelina Beqaj.

z.Besnik Seferi; Nga LVV-ë unë propozoj Adnan Ademi të shkojë me automatizëm si Kryesues i KPF-së ndërsa si anëtarë të KPF-së propozoj Sanije Sadikun, ndërsa për Rexhep Gashin që e kishim propozuar më parë, unë propozoj që të ndryshohet dhe e propozoj vetveten Besnik Seferi, meqenëse paskemi të drejtë me ligj dhe meqenëse këtu u bënë disa propozime të tilla. Pra propozimi është Adnan Ademi, Sanije Sadiku dhe Besnik Seferi. Sido qoftë unë propozoj që mbledhja të shtyhet për një ditë tjetër.

z.Muhamet Ademaj; Në emër të LDK-AKR-së unë e propozoj Kadri Eminin.

z.Rexhep Gashi; Unë nuk po e kuptoj Besnikun njëher e falenderova që më propozoi e tash e ndryshoi propozimin, vërtetë nuk po e kuptoj kujt i shërbejnë këto lojta.

z.Reshat Mujota; Unë e propozoj vetveten Reshat Mujota por edhe Heroina Selmanin.

z.Besnik Seferi; Replikë me Rexhep Gashin, unë nuk i nënshtrohem asnjë gjëje, unë po flas vetëm për parimet. Unë nuk bëhem patericë e askujt. Unë jam thjeshtë vetvetja.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse nuk po mund të gjejmë zgjidhje të pranueshme jemi të detyruar që të shkojmë me votim për secilin kandidat. Në vazhdim Konstatohet, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës Unanimisht vendosi që Përparim Ramusa, të jetë anëtarë i KPF-së.**

***Kuvendi i Komunës Unanimisht vendosi që Adelina Beqaj, të jetë anëtare e KPF-së.**

***Kuvendi i Komunës, me 20 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" vendosi që Lumni Amrushit, të jetë anëtarë i KPF-së.**

***Kuvendi i Komunës Unanimisht vendosi që Adnan Ademi, të jetë anëtarë i KPF-së.**

***Kuvendi i Komunës Unanimisht vendosi që Sanije Sadiku, të jetë anëtare e KPF-së.**

***Kuvendi i Komunës, me 10 vota "Për" me 10 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" vendosi që Rexhep Gashi të jetë anëtarë i KPF-së, pasi që (Kryesuesi i Kuvendit përdori të drejtën e tij për votën shtesë sipas nenit 48.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040 dhe në këtë rast votoi "Për" kështu që rezultati u bë me 11 vota "Për").**

***Kuvendi i Komunës, me 10 vota "Për" me 11 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" nuk e aprovoi propozimin që Kadri Emini të jetë anëtarë i KPF-së.**

***Kuvendi i Komunës, me 11 vota "Për" me 3 vota "Kundër" dhe me 7 vota "Abstenim" vendosi që Heroina Selmani, të jetë anëtare e KPF-së.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pasi që u votuan secili propozim veç e veç, Konstatohet se u formua Komiteti për Politikë dhe Financa në përbërjen si vijon:

1. Adnan Ademi – Kryesues,
2. Përparim Ramusa – Anëtar,
3. Lumni Amrushit – Anëtar,
4. Adelina Beqaj – Anëtare,
5. Sanije Sadiku – Anëtare,
6. Rexhep Gashi – Anëtarë,
7. Heroina Selmani – Anëtare.

z.KadriEmini; Unë jam i bindur se këtë votim të Komitetit për Politikë dhe Financa do ta kthejë MPL-ja, prandaj po kërkoj që kjo me u shënuar në Procesverbal si vërejtje e imja.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Edhe unë po them se me këtë vendim është bërë shkelje e nenit 53 pika 1 e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe Rregullores, si dhe është në kundërshtim me shpjegimin që e dha zyrtari ligjor, se në këtë përbërje të Komitetit për Politikë dhe Financa nuk janë të përfaqësuara të gjitha subjektet politike që janë pjesë e Kuvendit. Edhe një qështje kisha dashur që ta sqarojmë meqenëse u diskutua shumë, qështja e votimit ose jo të marrjes së një pauze, unë nuk dua që në asnjë

pikë të bëjmë shkelje ligjore, prandaj po kërkoj nga zyrtari ligjor të na sqaroj nëse pauza duhet të votohet ose jo nga Kuvendi.

z.Lulzim Muharremi, zyrtar ligjor; Nuk shkruan askund se duhet të votohet marrja e një pauze.

z.Reshat Mujota; Dua të sqaroj disa dilema, se unë këtu kam ardhur me votën e qytetarit, dhe kam identitetin tim.

z.Rrahman Jakupi; Duhet me ditë zyrtari ligjor se a është fjala këtu për Etnitet apo është për Entitet sepse unë në këtë fushë kam një përvojë të gjatë, prandaj në këtë rast LVV-ja propozoi një anëtarë të një Entiteti tjetër, dhe ne nuk i kemi fajet për stërgjatjen e kësaj mbledhje të Kuvendit.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Dha disa sqarime, Për hir të korrektësisë dhe të ligjshmërisë unë kisha kërku me u sqaru mirë ky proces nga zyrtari ligjor sepse ky proces i votimit ka tendenca me u deformu, nga disa asambleistë, dhe me sa po e kuptojë unë, nuk janë takort me atë çka e tha përfaqësuesi ligjor, sepse duke pas mundësinë e votës, një asambleisti të një entitet politik po mbetet pa u përfaqësuar në Komitetin për Politikë dhe Financa në këtë Komitet kaq të rëndësishëm një entitet i konsolidum, kjo po duket hapur që është shkelje e Ligjit i cili thot se Subjektet e përfaqësuara në Kuvend duhet të reflektojnë edhe në KPF. Përfaqësuesi Ligjor po besojë që i rexhistron dhe ka me i nxjerrë si gabim, gjithashtu edhe MPL-ja ka me e konfirmuar Ligjshmërinë e tyre. Këtë po e them për hir të korrektësisë edhe me juve edhe me qytetarët. Unë kisha kërku edhe një interpretim nga përfaqësuesi ligjor për atë që ishte para pauzës për një qartësi dhe korrektësi më të madhe lidhur me atë që Kryesuesi i Seancës, kërkojë pauzë, dhe nga opozita kërkuan që duhet të hedhët në votim z.Muharremi a ka mundësi me e gjet në rregullore nëse shkruan dikun që për një pauzë, duhet me u hedh në votim.

z.Lulzim Muharremi, zyrtar ligjor; Jo nuk shkruan askund që duhet të votohet pauza.

z.Përparim Ramusa; Faji për këtë ishte te subjekti i juaj LVV-ë, që propozoi anëtarë të subjektit tjetër politik, në këtë rast të Lëvizjes për Bashkim.

Pika 3

Zgjedhja e Komitetit për Komunitete

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Hamëz Tërshani; Mendoj se kemi një shkelje të kësaj pike, sepse një propozim është mshefë. Personalisht nuk kam asgjë, por po bëhet fjalë për një anëtarë të KPK-së, prandaj kërkoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen tjetër.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; E falënderoj zotëri Hamëz Tërshanin për diskutimin, fjalën ja kaloj Kryetarit për të na dhënë sqarimet e nevojshme.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Ideja e përfaqësimit të anëtarëve të komunitetit pakicë në Komitetin për Komunitete është parimore, thjeshtë duam që në këtë Komitet të ketë përfaqësim gjithpërfshirës nga qytetarët e komunitetit pakicë edhe përfaqësim nga subjektet e tyre politike edhe përfaqësim nga shoqëria civile, sikurse që kemi pas parasysh që të kemi edhe përfaqësimin gjinor. Ne kemi pas një bashkëpunim me të gjitha këto struktura dhe kemi komunikuar me të gjithë pa dallim. Propozimi që ka ardhur për Kuvend i ka të përfshira të gjitha strukturat që i përmenda. Nuk është ideja jonë që në Komitet të propozojmë anëtarë vetëm e vetëm se kanë qenë shumë vite me radhë, dhe vetëm e vetëm se kanë qenë në shërbimin e politikës së juaj. Ne i kemi propozimet që i kemi përcjellë në Kuvend e që na kanë ardhur nga përfaqësuesit e subjekteve dhe të shoqëris civile të Komunitetit Ashkali dhe Rom, tani është në dorën e Kuvendit nëse e zgjedh Komitetin për Komunitete ose jo.

Muhamet Mehmeti, është nga komuniteti Ashkali i cili përfaqëson PAI-në. Shkurte Behluli nga komuniteti Ashkali që e përfaqëson IRDK-në. Arton Demiri nga komuniteti Rom, që e përfaqëson PREBK-në. Bajram Ilazi nga komuniteti Ashkali që i përfaqëson OJQ-të.

z.Besnik Seferi; Unë vërtetë nuk po e di se qka po ndodhë tash, ja kemi filluar me i zgjedhë komitetet dhe po vazhdojmë.

z.Rrahman Jakupi; Mendoj se ka shkelje, sepse atë dokument është dashur me e sjellë në Kuvend. E kuptoj qëllimin e mirë të juaj, por ne e kemi më mirë, mendoj se kjo pikë duhet të shtyhet.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Ne nuk mund të bëjmë referendum për ti zgjedhur përfaqësuesit e komuniteteve në Komitetin për Komunitete, edhe pse kjo do të ishte më e mira, por siq e sqarova në propozimin për Kuvend i kemi sjellë emrat e të gjithë anëtarëve që paraqesin një përfaqësim solid të të gjitha strukturave të komunitetit pakicë. Ndërkaq që ju po dëshironi ta mbronni një partner të juajin të mëparshëm, por kjo është komplet joparimore nga ana juaj, dhe nuk ka të bëjë me mbrojtjen e interesit të komunitetit Ashkali dhe Rom në komunën tonë.

z.Rrahman Jakupi; Po supozojmë se është ashtu, por ai nuk është këtu, ai ka bërë punë, dhe tani po i shkilet e drejta.

z.Rexhep Gashi; Sot në mbledhjen e parë po hasim në vështirësi, jo për shkak të menagjimit të mirë por për shka të qëllimit për me futë mjegulli. Partia PAI i ka sjellë dy emra e që nuk është dashur me i sjellë dy emra por vetëm një emër me një listë.

z.Hamëz Tërshani; Lexoi një dokument të partisë PAI ku partia i ka dërguar 2 përfaqësues. Ne po e mbrojmë të drejtën e përfaqësimit, le të vijnë krejt propozimet që ti votojmë.

z.Besnik Seferi; Tu kisha lut me respektu rregulloren. Asjëherë në këtë Kuvend nuk ka pas përfaqësim më të mirë të komunitetit Ashkali dhe Rom në komunën tonë që është propozuar për Komitet për Komunitete. Personin që po insistoni me e futë në Komitet është që nga fillimi, pse mos me e ndryshuar, kur vetë partia ka dhënë një mundësi të tillë. Nuk po kërkojmë me futëdikend që nuk është fare i propozuar nga Komuniteti. Neve na takon me dhënë një votë ku janë të përfaqësuar të gjitha komunitetet.

z.Përparim Ramusa; Rregullorja thot me e qitë në votim propozimin për shtyrje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse diskutimet u shterrën kërkoj që të jepni propozimet e juaja për anëtarë të Komitetit për Komunitete.

z.Përparim Ramusa; Ne nuk kemi propozim sepse kemi kërkuar që kjo pikë me u shty.

z.Besnik Seferi; Ne propozojmë Shkurte Mustafa.

z.Kadri Emini; Ne propozojmë Muhamet Ademaj.

z.Rexhep Gashi; Unë propozoj Reshat Mujota.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Tani po i qes në votim në paket propozimet e dhëna, ku i kemi tri propozime nga Kuvendi dhe 4 propozime nga Komuniteteti Ashkali dhe Rom për anëtarë të Komitetit për Komunitete. Në vazhdim Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës, me 11 vota "Për" me 9 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" zgjodhi Komitetin për Komunitete në këtë përbërje si vijon:**

1. Shkurte Mustafa, Përfaqësues nga Kuvendi- LVV,
2. Muhamet Ademaj, Përfaqësues nga Kuvendi- LDK-AKR,
3. Reshat Mujota, Përfaqësues nga Kuvendi- i pavarur,
4. Muhamet Mehmeti, përfaqësues nga komuniteti Ashkali - PAI,
5. Shkurte Behluli, përfaqësues nga komuniteti Ashkali - IRDK,
6. Arton Demiri, përfaqësues nga komuniteti Rom - PREBK,
7. Bajram Ilazi, përfaqësues nga komuniteti Ashkali - OJQ,

Pika 4

Zgjedhja e Komitetit për Arsim, Kulturë Rini dhe Sport

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; Kërkoj sqarim nga Kryesuesi se si është qelësi.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; E dini se jemi akorduar që ky Komitet të ketë 5 anëtarë.

z.Përparim Ramusa; Propozoj që ne si PDK të kemi tre anëtarë.

z.Rrahman Jakupi; Pajtohem me propozimin e Perparimit.

z.Përparim Ramusa; Ne nga PDK-ja propozojmë Hasan Avdylin, Besartë Musliu-Spahija dhe Albana Podvorica.

z.Besnik Seferi; Ne nga LVV-ja propozojmë Besnik Seferi dhe Gëzim Haxhiu.

z.Muhamet Ademaj; Ne nga LDK-AKR-ja propozojmë Rrezartë Ramadani.

z.Besnik Seferi; Nëse dakordohet LDK-AKR që ne me i pasë tre anëtarë mirë nëse jo atëherë unë po e ndryshoj propozimin ku do të propozoj Besnik seferi dhe Asllan Beqaj.

z.Përparim Ramusa; Atëher, po propozoj që anëtarë të Komitetit për Arsim nga PDK, të jetë Hasan Avdyli dhe Albana Podvorica.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Tani po i qes në votim në paket propozimet e dhëna, ku i kemi pesë propozime. Në vazhdim Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës Unanimisht, zgjodhi Komitetin për Arsim, Kulturë Rini dhe Sport, në këtë përbërje si vijon:**

1. Hasan Avdyli – PDK,
2. Albana Podvorica – PDK,
3. Besnik Seferi – LVV,
4. Asllan Beqaj – LVV,
5. Rrezartë Ramadani – LDK-AKR.

Pika 5

Zgjedhja e Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale, Ambient e Shërbime Publike

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa: Ne nga PDK-ja për anëtarë të Komitetit të shëndetësisë propozojmë, Rrahman Jakupi, Adem Ramadani, Hasan Avdyli, Hamëz Tërshani dhe Besartë Musliu-Spahija.

z.Besnik Seferi; Ne nga LVV-ja për anëtarë të Komitetit të shëndetësisë propozojmë, Besnik Seferi dhe Gëzim Haxhiu.

z.Muhamet Ademaj; Ne nga LDK-AKR për anëtarë të Komitetit të shëndetësisë e propozojmë Kadri Eminin.

z.Kadri Emini; Po shihet qartë se subjektet e mëdha nuk janë për me bë zgjidhje, sepse u pa se unë nuk mora votat e mjaftushme për me hy në KPF, ashtu pra edhe këtu në këtë Komitet nuk mar votat prandaj unë po tërhiqem.

z.Besnik Seferi; Ne kemi propozuar sipas ligjit 2 anëtarë, kështu që Kadriu nuk duhet të tërhiqet, e as unë nuk po tërhiqem. Është absurde të bëhen propozime të tilla prej 5 anëtarëve nga PDK-ja. Unë po kërkoj që të bëhet fjalë pak e punë shumë.

z.Rrahman Jakupi; Ne mendojmë se vendimi për zgjedhjen e Komitetit për Komunitete ka me u kthye nga MPL-ja për rishqyrtim. Edhe unë po deklarohej se tërhiqem nga kandidimi në këtë Komitet.

z.Kadri Emini; Unë po e tërheqi fjalën nga ajo që thash më parë se tërhiqem nga kandidatura.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Tani po i qes në votim zgjedhjen e Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale, Ambient e Shërbime Publike. Në vazhdim Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës Unanimisht, zgjodhi Komitetin për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale, Ambient dhe Shërbime Publike, në këtë përbërje si vijon:**

1. Hasan Avdyli – PDK,
2. Adem Ramadani – PDK,
3. Hamëz Tërshani – PDK,
4. Besartë Musliu-Spahija – PDK,
5. Besnik Seferi – LVV,
6. Gëzim Haxhiu – LVV,
7. Kadri Emini – LDK-AKR,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Dha 1 orë pauzë për drekë.
Mbledhja e Kuvendit vazhdoi pas pauzës në ora 15.00h

Pika 6

Pyetje - Përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Kadri Emini; Përshëndetje, unë realisht nuk kam ndonjë pyetje meqenëse është mbledhja e parë e rregullt e Kuvendit, por vetem desha të bëj një përshëndetje për kolegët deputet, ekzekutivin dhe gjithë mysafirët, dhe uroj punë të mbarë.

z.Reshat Mujota; Përshëndetje, edhe unë nuk kam ndonjë pyetje konkrete por njësoj sikurse kolegu paraprak, dua të përshëndes dhe të uroj punë të mbarë.

znj.Albana Podvorica; Ka thënë në mbledhje të Kuvendit se diskutimin tim do ta sjelli në sekretarinë e Kuvendit në formë të shkruar, por nuk e ka sjellë. (Sekretaria - meqenëse znj.Albana Podvorica, e ka lexuar një tekst gjatë diskutimit të sajë, sekretaria nuk ka pas mundësi me nxënë diskutimin për procesverbal).

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, nashta kishte me qenë mirë me qenë prezent Kryeatri Aliu, ose drejtori i Shërbimeve Publike, sepse gjatë fushatës që kemi pas, Kryetari Aliu, gjithëmonë është thirrur në Lumin Shtimjanja do ta bëjë këtë e do ta bëjë atë, mirëpo siç po verehet nuk ka bërë asgjë, erdhën mërgimtarët e shkuan dhe Lumi Shtimjanja përplot me bërlllog, nese nuk mundet me bërë le të kërkon bashkëpunim sepse ne mundemi me i dhënë. Dhe një pyetje për Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, qyshë është gjendja te Halla e Sporteve?

znj. Besartë Musliu-Spahija; Përshëndetje, unë i kam tri pyetje, e para me rastin e shënimit të përvjetorit të Masakrës së Reçakut, shumë familjarë të dëshmorëve më kanë parashtruar pyetje, pse nuk janë ftuar në orën përkujtimore në shtëpinë e kulturës në Shtime? Këtë çështje po e ngris pasi që edhe vetë jam pjesë e familjeve të dëshmorëve. Pyetja e dytë është, pse ne anëtarët e Kuvendit të zgjedhur me votat e popullit nuk jemi ftuar në orën përkujtimore, ndërsa të emëruarit politik të afërt me Kryetarin si drejtorat kanë qenë të thirrur, a nuk do të kishte qenë më mirë që aty të ishin ulur familjarët e dëshmorëve dhe të rënëve? Dhe pyetja ime e tretë është pse në këtë përvjetor nuk është përmendur Komandanti, Ahmet Kaçiku, dhe bashkëluftëtarët e tij?

z.Përparim Ramusa; Nuk kam ndonjë pyetje, por edhe pse kemi pas një bashkëpunim, me Kadriun por nuk pajtohem me disa gjëra lidhur me përgjigjet e drejtorave të mëparshëm.

z.Lulzim Sahiti, drejtor i DKA; Përshëndetje, në komunën tonë deri tani i kemi gjithësej 4 shkolla që janë duke mbajtur mësimin online, në shkollat në Shtime por edhe në fshatin Muzeqinë. Gjithashtu e kemi të mbyllur përkohësisht edhe Qerdhen e fëmijëve "Albiona Asllani" sepse edhe aty ka pasë të infektuar në rritje. Nga muaji Janari deri më sot janë raportuar të infektuar me KOVID - 166 nxënës, 55 mësimdhënës, dhe 5 punëtorë ndihmës. Duhet përmend faktin QKMF – ka organizuar për herë të parë testet rapide nëpër shkolla dhe nuk ka pasë nevojë me shku nxënësat në QKMF e që duhet me i falenderuar për një punë shumë të mirë.

z.Albana Fazliu, drejtoreshë e DKRS; Përshëndetje, përgjigjen në pyetjen e Adelina Beqaj do ta jap me shkrim në mbledhjen e radhës të Kuvendit.

znj.Adelina Beqaj; Unë nuk e kërkoja ndonjë përgjigje ku me ditë se fare, por vetem desha me dit se a i ke vizituar ndonjëherë hallën e sporteve dhe shtëpinë e kulturës dhe si tu ka dukur gjendja e tyre aty ku duhet të mbahen aktivitete kulturore e sportive.

z.Albana Fazliu, drejtoreshë e DKRS; Po unë i kam vizituar shtëpinë e kulturës, edhe palestrën sportive, dhe e di se si është gjendja, normalisht se është keq sepse edhe keq e kenë lënë, mirëpo jemi në konsultime të vazhdueshme me Kryetarin se duhet të kemi ndryshime, në përmirësimin e gjendjes te këto objekte.

Pika 7

Raport vjetor i buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor 2021

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë, fjalën ja dha Bujar Feratit për prezantimin e kësaj pike.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Përshëndetje, unë nuk do të ju marr shumë kohë, sepse materialin e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar, (Shih dokumentin). Në dokument janë të prezantuara detaisht projektet dhe realizimi i tyre, ato projekte që kanë pas impakt në përmirësimin e jetës së qytetarit. Ju ftoj që ta miratoni raportin, dhe nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem.

z.Hamëz Tërshani; Përshëndetje, unë e falenderoj Bujarin për raportin, e kam lexuar dhe do ta votoj, ndërsa pyetje nuk kam.

z.Muhamet Ademaj; Përshëndetje, e falenderoj ZKF-në për raportin, e kam lexuar dhe është parë që buxheti është shfrytëzuar mirë, kështu që ne do ta votojmë.

z.Rexhep Gashi; E përshëndes ZKF-në për një raport të mirë. Po ashtu i përshëndes qytetarët për një përgjigje të mirë në tatimin në pronë.

z.Reshat Mujota; Te të hyrat vetanake, unë e kam një pyetje për ZKF-në, se a kemi të hyra të përfshira në këtë raport për sa i përket tregut dhe parkingut publik, kërkoj një sqarim.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje për ZKF-në, kemi vërejtje por shpresoj që edhe Kryetari aktual do të bashkëpunoj, kështu që ne do ta votojmë këtë raport financiar.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, besoj se ky raport duhet të kalojë, sepse është përgatitur mirë.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Të hyrat nga parkingjet dhe tregjet janë të kodifikuara, por përgjigjen do ta merrni me shkrim.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Tani po i qes në votim Raportin vjetor të buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor 2021. Në vazhdim Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimitisht miratoi Raportin Financiar të Komunës së Shtimes për vitin 2021.**

Pika 8

Draft-Rregullore komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; Meqenëse rregullorja e parasheh që të shkojë në diskutim publik ne do të votojmë që të shkojë në diskutim publik.

z.Besnik Seferi; Mendoj se nuk ka mundësi të shkojë në diskutim publik për arsye se jemi tepër vonë, ne është dashur që me fillimin e vitit 2022 ta kemi rregulloren për taksa të miratur dhe nga 1 Janari me ja fillu implementimin e sajë.

z.Kadri Emini; Edhe unë pajtohem që të shkojë në diskutim publik, ashtu siç thanë edhe kolegët.

z.Rexhep Gashi; Edhe unë pajtohem që të shkojë në diskutim publik, sepse është interes i qytetarit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Tani po e qes në votim, propozimin që Rregullorja për Taksa të shkojë në diskutim publik. Në vazhdim Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi Komunës, unanimitisht aprovoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Propozim-Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2022, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Zyra Komunale për Financa në bashkëpunim me Zyrën për Informim.**

Pika 9

Zgjedhja e Komisionit për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për 2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; Pajtohem që ta formojmë Komisionin për hartimin e planit të punës, kështu që nga PDK-ja propozojmë, Hamëz Tërshani.

z.Besnik Seferi; Unë e propozoi Sanije Sadikun.

z.Muhamet Ademaj; Unë e propozojë Rrezartë Ramadanin.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Tani po i qes në votim, propozimet për zgjedhjen e Komisionit për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për 2022. Në vazhdim Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi Vendimin për formimin e Komisionit për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2022, në këtë përbërje:**

1. Hamëz Tërshani, - (PDK)
2. Sanije Sadiki, - (LVV)
3. Rrezartë Ramadani, - (LDK)

Pika 10

Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të rregullta të KK për 2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; Unë propozoj që nga orari i mbledhjeve të rregullta të Kuvendit, të përjashtohet dita e Premte, për arsye se gjithë ata që e falin namazin e kësaj dite, shpesh herë nuk po mund ta arrijnë, prandaj më mirë ta hjekim nga orari i mbledhjeve, dhe të vendoset një ditë para ose të hënën.

z.Besnik Seferi; Edhe unë jam që të hiqet dita e premte.

z.Kadri Emini; Unë propozoj që seancat e Kuvendit të fillojnë nga ora 9 e jo në ora 10 siç ishte më parë, kjo me qëllim që të kemi kohë mjaftueshëm për ta përfunduar seancën para dite.


Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Tani po i qes në votim, propozimet për largimin e ditës së Premte nga orari i mbledhjeve sikurse edhe propozimin që seancat e Kuvendit të fillojnë nga ora 9.00h. Në vazhdim Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës, me 20 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” aprovoi Vendimin për caktimin e orarit të mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës për vitin 2022, me vërejtjet që:**

1. Dita e Premte përjashtohet nga orari i mbajtjes së mbledhjeve, dhe
2. Seancat e Kuvendit do të fillojnë në ora 9.00h.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoj në ora 16.20h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

